Përherë të parë UKZ ka fituar projektin më të madh deri më tani dhe i pari si Koordinator në programin e Komisionit Evropian Erasmus + " Ngritja e Kapaciteteve të Zyrave për bashkëpunim Ndërkombëtar, zhvillimi i cilësisë dhe menaxhimin e projekteve", me 18 partnere, vendorë, rajonal dhe evropian. Projekti QUADIC ka të bëjë me ndërkombtarizimin e universiteteve si dhe ngritjen e kapaciteteve për projektet ndërkombëtare, aplikuar si koordinator nga Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan në thirrjen e fundit të programit Erasmus +, duke u pranuar si i suksesshëm dhe do të financohet nga Komisioni Evropian në vlerë prej 991.381 Euro.

Universiteti "Kadri Zeka" është koordinator i projektit dhe ka gjithsejtë 18 partner vendor, regjional dhe ndërkombëtar, që dëshmon edhe një herë se kapacitetet e UKZ-së janë të jashtëzakonshme marrë parasysh numrin e personelit që ka, duke argumentuar gjithnjë e më shumë se ndërkombëtarizimi dhe

zhvillimi i projekteve janë fushat në të cilat jo vetëm UKZ por të gjitha universitetet e Kosovës duhet të punojnë dhe të orientohen për të arritur në standardet që kanë universitetet nga Unioni Evropian dhe në këtë mënyrë duke rritur edhe cilësinë në studime.

Ky projekt do të jetë një mundësi e mirë për partnerët nga Kosova dhe regjioni që të rrisin kapacitetet e tyre në ndërkombëtarizim dhe në shkrim të projekteve ndërkombëtare, gjithmonë të ndihmuar nga partnerët Evropianë, si Universiteti i Nicës, Universiteti i Lubjanës, Universiteti Teknik i Sofjes dhe Universiteti i Perugias.

Në kuadër të këtij projekti është realizuar vizita në EACEA, Bruksel, ku stafi menaxhues janë ftuar në Takimin e përvitshëm të Grant Mbajtësve të projekteve. Në këtë vizitë kanë marr pjesë: prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka, Luljete Berisha dhe Selim Daku. Gjatë këtyre ditëve, është mbajtur punëtoria me të gjithë koordinatorët dhe partnerët e projekteve në kuadër të Erasmus + nga e gjithë bota, ndërsa në takimin e ndarë në Bilateral Meeting është prezantuar Projekti QUADIC dhe e gjitha mënyra e implementimit para përfaqësueses së EACEA znj. Inmaculada, e cila do të jetë edhe mbikëqyrëse e këtij projekti deri në fund dhe tri zyrave te Erasmus + në Kosovë, Shqipëri dhe Mali i Zi,.

Ky projekt ka filluar implementimin ne Shkurt të 2020 dhe do te zgjasë për 3 vite. Aktivitetet e para të këtij projekti kanë filluar më datën 11.2.2020.

*Dita e parë-* Hapjen e fillimit të implementimit të projektit e bëri Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, i cili fillimisht falënderoi Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar të UKZ-së Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka, njëherësh koordinator i projektit QUADIC, për punën e vazhdueshme në ndërkombëtarizimin e Universitetit dhe të gjithë partnerët pjesëmarrës në këtë projekt, duke thënë se ndihet i lumtur që sot po fillojmë një projekt kaq madhor.

Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar në UKZ, Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka, njëherësh koordinator i projektit QUADIC, ka prezantuar projektin, ku ka thënë se i gjithë projekti është përfshirë në 10 paketa. E para përfshinë katër elemente kryesore, kick off meeting, ëorkshop, prezantimi i partnerëve, prezantimi i strategjisë për ndërkombëtarizim dhe zhvillimin e projektit, qëllimet dhe objektivat që priten si produkt i projektit.

Në aktivitetin e parë që ka filluar me Kick Off Meeting, organizuar nga Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar, kanë marrë pjesë të gjithë partneret vendor dhe ndërkombëtar, gjithsejtë 18 përfaqësues të institucioneve, si: Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan, Coordinator/ Grant Holder, International Business College Mitrovica, Universiteti i Gjakova "Fehmi Agani", Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Universite de Nice Sophia Antipolis, Technical University of Sofia, Universiteti i Mjekësisë në Tiranë, University of Ljubljana, Heimerer College, Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka", Universiteti i Durrës "Aleksandër Xhuvani", Universiteti i Mitorvicës "Isa Boletini", Univesiteti Europian i Tiranës, International University for Business and Technology, Universiteti i Korçës "Fan S. Noli", Universiteti i Gjirokastrës "Eqrem Qabej", Universita Per Stranieri Di Perugia.

*Në ditën e dytë* të projektit QUADIC, që është mbajtur në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan, të gjithë partnerët kanë punuar së bashku sipas planit të veprimit që ka për qëllim, arritjen e synimeve të përbashkëta, të kuptuarit e koncepteve dhe përmbajtjes si bazë për miratimin e punës pedagogjike, krijimin e modelit të punës në ndërkombëtarizim dhe menaxhim të ciklit të projektit.

Në ndërkohë është mbajtur punëtoria për burimet njerëzore; Infrastrukturën dhe përdorimin e teknologjisë; Statusi i IRO-së brenda universiteteve; si dhe lidhjen e IRO me organizata të ndryshme.

Koordinatori i projektit QUADIC, Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka, ka thënë se zhvillimi i marrëdhënies ndërkombëtare dhe plani i strategjisë së menaxhimit të ciklit të projektit është shumë i rëndësishëm. Nga ana tjetër edhe përfaqësuesit e pjesëmarrëseve në projekt kanë thënë se themelimi / funksionalizimi i marrëdhënies ndërkombëtare dhe vet projektit është i rëndësisë së veçantë.

Po ashtu është diskutuar edhe Paketa e 1, 2, 3 dhe 4 e projektit, që është blerja e pajisjeve, mbajtja e kontaktit me partnerët rajonalë, përgatitja e dosjes së tenderit dhe specifikimi i teknikave, hapja publike e tenderit, kontrata dhe blerja e pajisjeve, procedurat e prokurimit, menaxhimi i kontratës, zhvillimi i softuerit, aplikacioneve dhe platformave online etj.

*Dita e tretë-* Gjatë punëtorisë së projektit QUADIC, janë diskutuar tri paketa ku pjesëmarrësit e 18 institucioneve që janë pjesë e projektit, kanë biseduar dhe prezantuar planin e veprimit. Në ndërkohë për të parë rrjedhën e punëtorisë së projektit në fjalë, në UKZ ka qëndruar në një vizitë Prof. Dr. Ali Jashari, Rektori i Universitetit "Fan S. Noli" në Korçë. Ai është pritur në takim nga Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Kadri Zeka", Vaxhid Sadriu dhe profesori Bahtijar Kryeziu. Derisa, punëtoria e projektit QUADIC ka vazhduar me aktivitetin e saj, është prezantuar paketa e 5 që ka pasur për diskutim trajnimin në të gjitha nivele për stafin drejtues dhe mësimdhënësit në shkrimin e projektit, trajnimin për menaxhimin e projekteve të stafit në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe mobilitetet, trajnimin e stafit administrativ në administrimi i mobilitetit të studentëve dhe stafit. Partnerët në projekt janë dakorduar që në aktivitetet e lëvizshmërisë të përfshihen sa më shumë studentë, sepse sipas tyre kjo është mjaft e rëndësishme , pasi që në këso raste rritet edhe vlera e rezultateve, ku studentët mund të përfitojnë nga bashkëpunimet e ndërsjellat universitare.

Paketa 6, përfshinë zhvillimin strategjik, ku është paraparë që Anëtarët e Komitetit Drejtues të projektit, të mblidhen në punëtori për të punuar në vizionin e IC / PM, misioni dhe strategjitë. Në këto ngjarje, pjesëmarrësit do të bien dakord për nisma të përbashkëta (përfshirë Rrjetin e Bashkëpunimit Rajonal në Arsimi i Lartë), propozime projektesh të përbashkëta për financim nga BE, strategjitë për ndërkombëtarizim dhe bashkëpunim, programet e mundshme të përbashkëta rajonal dhe ndërkombëtar, lehtësimi i njohjes së ndërsjellë të kredive, partneriteteve të reja, praktikat inovative dhe më të mira në ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë dhe menaxhimin e projektit, etj.

Paketa e 7 ka të bëjë me themelimin e Shoqatës së IAL – Vendosja e bashkëpunimit ndërmjet partnerëve e projektit si dhe brenda partnerëve e rrjetit. Po ashtu gjatë kësaj pakete është biseduar rreth zhvillimit të mekanizmave për arsim dhe shkëmbime shkencore ndërmjet partnerëve e konsorciumit, me mjetet e dakorduara të koordinim / komunikim, rrjetëzim. Organizimi i punëtorive për burimet njerëzore, për përdorimin e teknologjisë, statusi i IRO-së brenda universiteteve si dhe lidhjet e IRO-së me organizata të ndryshme.

*Dita e katërt-* Në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan, kanë përfunduar punimet e projektit QUADIC – Quality development of international cooperation and project management, projekt ky i fituar nga UKZ në programin ERASMUS + Cooperation for Innovation and the exchange of good Practices, në thirrjen e fundit Capacity Building in Higher Education – Joint Projects.

Sot është diskutuar paketa e 9 punuese, që ka të bëjë me shpërndarjen dhe shfrytëzimin e rezultateve, zhvillimin dhe fillimin e projektit, uebfaqes në internet, zhvillimi i një komunikimi të projektit, plani / strategjia e shpërndarjes, dizajnimi, shtypja dhe shpërndarja e materialeve, konferenca për prezantimin e hulumtimit, raport vlerësimi, organizimi i konferencës përfundimtare të projektit, si dhe plani i veprimtarive. Në paketën e 10 është diskutuar menaxhmenti, siç është krijimi i Bordit, financat dhe administrata e projekti, kanalet e komunikimit: Google Drive, Skype, Platformë Dixhitale, Hangout, Doodle, etj.

- **Takimi i SC të projektit Rebus në Tiranë më 11-13 prill 2019.**

Nga 11 deri më 13 prill 2019 në UET të Tiranës (Shqipëri) u mbajt Takimi i (fundit) i SC 6 të Partnereve te projektit REBUS, ku nga UKZ ishin pjesëmarrës Prof. Xhevdet Thaqi, prof. Ekrem Halimi, dhe Drejtori i Financave të UKZ-së, mr. Valon Kllokoqi. Në këtë takim u shqyrtuan çështjet e përfundimit të aktiviteteve në kuadër të të gjitha WP (Paketave të punës) të projektit dhe hapat e ardhshëm në realizimin e aktiviteteve të planifikuara deri në përfundimin me sukses të Projektit REBUS përfshirë edhe raportimin në nivel të partnerëve dhe raportit final për EACEA.

- **Përfundimi i projektit REBUS**

Më 1.11.2019, Projekti Erasmus + REBUS, përfundon aktivitetet dhe realizon me sukses të gjitha objektivat e parapara. Edhe Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, prezanton raportin e tij final të punës së tij si partner në këtë projekt. Në raport janë përfshirë të gjitha aktivitetet e realizuara nga ekipi i punues nën drejtimin e koordinatorit Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi (rektor), prof. asoc. dr. Xhevdet Thaqi (Koordinator i projektit), prof. ass. dr. Dukagjin Leka (prorektor për marrëdhënie me jashtë), prof. Ass. dr. Ekrem Halimi, ass. Arbenita Kosumi etj.

Ndër rezultatet e arritura në kuadër të këtij projekti po veçojmë. Përfshirja e platformës MAHARA për përdorim të studentëve të FSHK dhe të Fakultetit Ekonomik të UKZ-së. Trajnimi i 60 studentëve në përdorimin e kësaj Platforme; Përgatitja, organizimi, financimi dhe realizimi i Vizitës studimore të 14 studentëve të UKZ në Universitetin e Grazit - Joanneum (AUSTRI); Akreditimi i programit master "e-qeverisja" në UKZ; Inicimi, , financimi dhe realizimi i Projektit "Digitalizimi i sallave të mësimit në FSHK të UKZ; Pajisja me Kabinetin e IT me 30 kompjuterë në FSHK (salla B24); Perfshirja e UKZ në Projektin e radhës "e VIVA" në kuadër të ERASMUS+; Trajnimi i 6 mësimdhënësve të UKZ-së në fushën e "Ndërmarrësia dhe inovacioni në studimet e IT"; Trajnimi i 60 studentëve në fushën e "Ndërmarrësia dhe inovacioni në studimet e IT" etj.

**UKZ është partnere edhe në 6 projekte të tjera në Erasmus +**

- **SMAHPC me Kolegjin Heimerer**

Në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan është mbajtur takimi i parë ose Kick Off Meeting i të gjithë partnerëve rë Projektit të koordinuar nga Kolegji Heimerer "Zhvillimi i qendrave multidisiplinare të praktikave shëndetësore për student" (Student-run Multidisciplinary Allied Health Practice Center / SMAHPC). Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar e UKZ-së ka qenë përgjegjëse dhe organizatore e këtij organizimi një javor që është mbajtur në sallën A34, pasi që UKZ është përgjegjëse për Paketën Punuese ËP1 Prepration. Me këtë rast janë udhëhequr edhe disa procedura të prokurimit për blerjen e materialit përgatitor për organizimin e kësaj ngjarje.

Ky është një projekt i financuar nga Komisioni Evropian në kuadër të programit Erasmus +, ku gjatë lansimit të projektit në fjalë e që koordinator është Kolegji Heimerer, kanë marrë pjesë të gjithë partnerët, Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, Metropolia University Finlande, JAMK University Finlande, Manisa University Turqi, Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë, MASHT, Instituti i Evropës Juglindore për Politika Shëndetësore dhe Sociale si dhe nga Organizata Joqeveritare Autizmi ne Kosovë.

Punimet e projektit i ka hapur prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar në UKZ, Dukagjin Leka, i cili e ka vlerësuar mjaftë të rëndësishëm bashkëpunimin e të gjithë akterëve në këtë projekt. Kurse Naime Brajshori nga Kolegji Heimerer, ka thënë se është e motivuar dhe e lumtur me fillimin e projektit më unike që është financuar nga Erasmus + gjegjësisht nga fondet e Bashkimit Evropian në Kosovë, për faktin se projekti që me raundin e parë është vlerësuar për mbështetje duke qenë në garë me qindra universitete evropiane e botërore dhe përmban partneritete vendore dhe ndërkombëtare të cilët janë përfituese të zhvillimit të praktikave profesionale multidisiplinare shëndetësore me metodat më moderne evropiane, me metoda të mësimdhënies të cilat gjejnë zbatim jo vetëm në Finlandë si një ndër shtetet elitë për cilësi në arsim por edhe më gjerë.

Aktivitetet do të vazhdojnë të zhvillohen në UKZ çdo ditë, nga ora 10.00-15.00 deri më 25 janar 2019.

Ndryshe, zbatimi i projektit "Zhvillimi i qendrave multidisiplinare të praktikave shëndetësore për student", që është i pari i këtij lloji në Kosovë, do të bëhet nëpërmjet rrjeteve, punëtorive, vizitave studimore, qarqeve rajonale të studimit, seminareve reflektuese si dhe shkëmbimit të njohurive dhe mësimeve të bazuara në praktikë.

Ky projekt është i financuar nga Programi Erasmus + i Unionit Evropian dhe përfshinë një konsorcium prej 9 partnerëve, prej tyre 6 partnerë vendorë dhe 3 evropian. Janë 6 institucione të arsimit të lartë, 2 organizata joqeveritare dhe MASHT.

- **E-VIVA me Universitetin Evropian të Tiranës**

Partneriteti përbëhet nga universitete nga BE dhe Ballkani Perëndimor si: Unternehmensberatung GmbH (Austria), Blended learning institutions' cooperative / blinc eG (Germany), Universiteti i Duisburg Essen / UDE (Gjermani), Universiteti Nova de Lisboa (Portugali), Universiteti i Malit të Zi, Universiteti i Donja Gorica, Universiteti Evropian i Tiranës, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Universiteti "Kirilit dhe Metodi" i Shkupit, Universiteti "Nënë Tereza", Universiteti i Sarajevës, Shkolla e Shkencës dhe Teknologjisë në Sarajevë (SSST), Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan, Kolegji "Universum", Universiteti i Nishit dhe Universiteti i Novi Sadit.

Me qëllim të marrjes së përvojave edhe nga universitetet dhe institucionet tjera jashtë vendit, ekziston bashkëpunimi ndërkombëtar. Kështu, Universiteti "Kadri Zeka" i ka kushtuar vëmendje të lartë organizimit në implementimin e projektit e-VIVA.

Krijimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm ndërmjet grupeve relevante të synuara dhe palëve të interesuara. Ky është një projekt i financuar nga Erasmus + me 16 partnerë, për një kohëzgjatje prej tre vjetësh.

Objektivat specifikë të projektit e-VIVA janë:

Nxitja qasjeve e bashkëpunimit midis akademisë dhe përfaqësuesve të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar; mbështetja e praktikës profesionale tek studentët kosovarë; zhvillimi dhe rafinimi i sistemeve gjithëpërfshirëse të vlerësimit të bazuar në TIK; pasurimi i sistemeve ekzistuese të vërtetimit dhe certifikimit; krijimi dhe aplikimi i një programi të pasur të zhvillimit dhe vlerësimit të kompetencave për të lidhura me shërbimin; aplikimi i sistemit të vlerësimit dhe evidencimit të aftësive profesionale.

- **Researchcult me IBCM Mitrovicë**

ResearchCul është projekt në kuadër të Programit Erasmus +. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë rritjen e kulturës së kërkimit në arsimin e lartë në Kosovë institucionet duke mbështetur forcimin e politikave dhe praktikave ekzistuese, si dhe krijimin dhe instalimi i rregulloreve dhe mekanizmave të rinj në institucionet përfituese të projektit në Kosovë.

Koordinator i këtij projekti është International Business College në Mitrovicë.

Kjo pritet të përmbushet duke arritur objektivat specifike të mëposhtme:

1: Vlerësimi i gjendjes aktuale të kapaciteteve kërkimore në sektorin e arsimit të lartë në Kosovë;

Fillimisht është e nevojshme për të marrë një pamje të qartë kohët e fundit të gjendjes aktuale të situatës së kërkimit në Kosovë, në termat e studiuesve të tanishëm, numri i botimeve të botuara ndërkombëtarisht në fusha të caktuara të prioritetet e kërkimit, vlerësoni rregulloret ekzistuese të universitetit për kërkimin shkencor dhe modalitetet për rishikim ato, si dhe aspekte të tjera (siç janë studiuesit sfidojnë të kryejnë veprimtari kërkimore dhe punë hulumtuese) që do të siguronte një situatë më të qartë që do të udhëzojë zhvillimin dhe instalimin e rezultateve të projektit në një mënyrë më të qëndrueshme.

2: Rritja e stimulimit dhe mbështetjes së kërkimit përmes krijimit të zyrave / qendrave universitare dhe të tyre planet strategjike për të mbështetur aktivitete të vazhdueshme kërkimore midis institucioneve të tyre.

Meqenëse universitetet në Kosovë (përveç Universitetit të Prishtinës) nuk kanë krijuar ende zyrë kërkimore dhe hartuar plane strategjike kërkimore, ky objektiv synon të mbështesë universitetet në trajtimin e këtyre boshllëqeve.

- **ENEMLOS me Universitetin e Podgoricës**

Klinikat Ligjore në shërbim të grupeve vullnetare: rritja e punësueshmërisë përmes edukimit praktik/ ENEMLOS. Ky projekt është në kuadër të programit ERASMUS +, Ngritja e Kapaciteteve në Arsimin e Lartë, të financuar nga Komisioni Evropian.

Koordinator i projektit është Universiteti i Podgoricës, Mali i Zi dhe ka gjithsej 15 partnerë: Fakulteti Juridik, Universiteti i Podgoricës; Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës; Universiteti i Pejës; Gjykata Supreme e Malit të Zi; Oda e Avokatëve në Mali të Zi; Zyra e Prokurorit të Shtetit, Mali i Zi; Oda e Noterëve, Mali i Zi; Oda e gjyqtareve, Mali i Zi; Qendra e Ndërmjetësimit, Mali i Zi; Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan; Gjykata Themelore Gjilan; Oda e Avokateve te Kosovës; Universitet Regent, Londër; Fondacioni i Klinikave Ligjore të Polonisë; Fakulteti Juridik, Universiteti i Zagrebit.

Projekti synon zhvillimin profesional të studentëve të Fakultetit Juridik në Universitetin "Kadri Zeka" dhe universitetet e tjera në Kosovë. Ky projekt do të jetë me një rëndësi të madhe në Kosovë, sepse ka mungesë praktike në ligj. Studentët përfundojnë fakultetin e tyre të drejtësisë, dhe akoma ka mundësi që të mos kenë praktikë deri në fund të fakultetit të tyre. Për këtë arsye ne kemi përfshirë në kurrikulat tona lëndët klinika juridike, por problemi kryesor është se akoma edhe profesorët nuk dinë të mësojnë lëndën. Deri më tani, klinika juridike po jepte mësim si teori, por asgjë në praktikë. Tani kemi filluar t'i dërgojmë studentët tanë ndonjëherë në gjykata.

Projekti do të synojë kryesisht studentët, në mënyrë që të rritet niveli i tyre i praktikës, i cili më pas do t'i ndihmojë ata në procesin e punësimit duke zhvilluar aktivitet profesional gjatë studimeve në klinikën ligjore. Klinika juridike mundëson zhvillimin e marrëdhënieve të drejtpërdrejta me qytetarë të ndryshëm, biznese apo klientë, gjë që i bën studentët të ndiejnë momentet më interesante që ata presin pas përfundimit të studimeve. Kjo ndikon në avancimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të aftësive të tyre praktike juridike.

Bashkëpunimi që ka UKZ me partnerët e tij akademikë u mundëson studentëve të orientojnë njohuritë e tyre në tregun aktual, do të thotë se ata do të ndërtojnë njohuritë e tyre bazuar në kërkesat e tregut. Kjo do të thotë që punëdhënësit do të jenë në gjendje të identifikojnë punonjësit e tyre të ardhshëm. Studentët që marrin pjesë në klinikën ligjore kanë një mundësi më të lartë se kolegët e tyre për t'u angazhuar në punë edhe gjatë studimeve dhe pas përfundimit të tyre.

Për më tepër, profesorët, asistentët dhe bashkëpunëtorët e tjerë do të kenë mundësinë për të rritur dhe zhvilluar njohuritë e tyre profesionale për praktikat që do të zhvillojnë me studentë dhe aktorë të tjerë në klinikën ligjore dhe jashtë saj.

Grupet e margjinalizuara janë ato që do të përfitojnë këshilla pro bono nga zbatimi i projektit. Me ndihmën e kësaj ndihme, këto grupe rrisin vetëdijen dhe idenë e realizimit të interesave të tyre kundër proceseve të ndryshme që mund të kenë. Për UKZ, bashkëpunimi midis universiteteve dhe ndërmarrjeve në rajon është shumë i rëndësishëm. Bazuar në strategjinë e zhvillimit, ne kemi parashikuar zhvillimin e këtij partneriteti i cili ka një ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e ndikimit të përgjithshëm dhe zhvillimit të rajonit.

Për UKZ, bashkëpunimi ndërinstitucional dhe rajoni janë përparësi të rëndësishme. Kjo për faktin se ndikon në lëvizjen e studentëve dhe stafit, gjithashtu në tregun e punës dhe mundësitë për të marrë dhe shkëmbyer praktikat ligjore. Fakulteti Juridik në UKZ aktualisht nuk ka Klinikë Ligjore, megjithatë, rastet dhe praktikat janë zhvilluar duke përdorur partnerë të tjerë institucionalë.

Mbështetja e këtij projekti për përfshirjen e studentëve dhe profesorëve në një klinikë arsimore juridike është një mundësi e favorshme që ndihmon në rritjen e efikasitetit në punë. Ndikon në zhvillimin e studentëve dhe profesorëve, kontribuon në avancimin e aftësive dhe aftësive të tyre, dhe gjithashtu rrit aftësitë e tyre profesionale.

Klinika ligjore gjithashtu do të zhvillojë aktivitete pro bono me interes publik. Shërbimet për këto aktivitete do të ofrohen nga studentë të mentoruar nga tutorë nga Fakulteti i Drejtësisë ose bashkëpunëtorët e tij.

Projekti mundëson zhvillimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe krijon një atmosferë të re në Fakultet që do të sjellë efikasitet më të lartë për grupet e synuara.

Fakulteti Juridik në UKZ ka identifikuar disa objektiva, të cilat janë paraqitur më poshtë:

1. avancimin e metodologjisë së mësimdhënies, duke shtuar pjesën praktike të klinikës së arsimit juridik;

2. Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së mësimit, bazuar në shkëmbimin e përvojave midis universiteteve në projekt;

3. Krijimi i mekanizmave të rinj të bashkëpunimit, lidhja e programeve të përbashkëta të mobilitetit të integruar;

4. Mbështetni ndërtimin e urave të bashkëpunimit midis institucioneve të përfshira, përfshirë fakultetet juridike përkatëse. Gjithashtu, avancimi i bashkëpunimit të këtyre institucioneve me strukturat e drejtësisë dhe të sigurisë në vendet përkatëse, përfshirë avokatët, agjentët e përmbarimit, noterët dhe aktorët e tjerë profesionistë që do të mundësonin aftësimin profesional të praktikës në studime.

**- Projekti QATEK me Universitetin e Prishtinës**

UKZ është pjesë e projektit QATEK, ku koordinator është Universiteti i Prishtinës.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të prezantojë mekanizma dhe aftësi në institucionet të arsimit në Kosovë për të zbatuar praktikat e brendshme të sigurimit të cilësisë që çojnë drejt përmirësimit të

cilësisë së të diplomuarve që janë të aftë për të çuar përpara reformën në shkollë. Rritja e cilësisë së të diplomuarve në arsimin e mësuesve në Kosovë ka potencialin për të ndikuar në ndryshimet e përhershme në praktikën shkollore të cilat janë pranuar si të nevojshme në sistemin shkollor të Kosovës. Ndryshimi i praktikës së mësuesve për të reflektuar profesionalizmin e ri nënkupton nevojën e zhvillimit të institucioneve të arsimit të mësuesve që janë të orientuar drejt përmirësimit dhe monitorimit të arritjeve të këtyre synimeve për të mbyllur boshllëkun domethënës midis realiteteve aktuale të praktikës së mësuesve në shkolla dhe profesionalizmit të kërkuar të mësuesve siç reflektohet në lokal aktual hartimi i politikave dhe referencat e nivelit evropian.

Qëllimet specifike të këtij projekti janë:

- Zhvillimi i mekanizmave dhe proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë brenda institucioneve fillestare të arsimit të mësuesve në Kosovë, të cilët i përgjigjen treguesve specifikë të cilësisë;

- Zhvillimi i kapaciteteve për menaxhimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë në arsimin e mësuesve, duke përfshirë miratimin e politikës së stafit të ITE dhe politikën e hartimit të lëndëve;

- Zhvillimi i kapaciteteve të arsimtarëve në ofrimin e cilësisë së mësimdhënies si një nga treguesit në mekanizmin e brendshëm të cilësisë;

- Implementimi i një procesi të sigurimit të plotë të cilësisë për të gjitha fushat përkatëse të edukimit të mësuesve (zbatimi i kursit, rëndësia e programit, programi hulumtues, bashkëpunimi ndërkombëtar, shërbimet studentore, praktikat administrative dhe menaxhuese, etj.) Për të identifikuar një program përmirësimi për institucionet e arsimit të mësuesve në Kosovë.

Katër elementët e mësipërm janë thelbësore për të lëvizur drejt një realiteti në të cilin institucionet fillestare të arsimit të mësuesve angazhohen vazhdimisht në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të programeve dhe cilësisë së shërbimeve të tij. Zbatimi i proceseve gjithëpërfshirëse të sigurimit të brendshëm të cilësisë brenda këtij projekti do të shënojë shtrirjen e praktikave aktuale të vlerësimeve të kursit drejt adoptimit të kulturës së përmirësimit që bazohet në reagimet e studentëve, stafit dhe shkollës mbi cilësinë e hartimit të programit, cilësinë e mësimdhënies, cilësinë e shërbimeve, etj. cilësia e hulumtimit, cilësia e bashkëpunimit ndërkombëtar, praktikat cilësore menaxheriale në institucionet e ITE. Projekti është vendosur në një pozitë të mirë për t'u mundësuar institucioneve partnere të zbatojnë praktikat e rishikimit dhe sigurimit të cilësive për të gjitha dimensionet e përcaktuara më lart për të hapur rrugën e zbatimit të qëndrueshëm përtej projektit. Zbatimi i sistemit gjithëpërfshirës të sigurimit të cilësisë nënkupton nevojën e zhvillimit të indikatorëve të cilësisë për të gjitha fushat e funksionimit të institucioneve fillestare të arsimit të mësuesve, zhvillimin e instrumenteve dhe proceseve, si dhe zbatimin e vërtetë të sistemit të ri dhe duke vepruar në bazë të feedback-ut dhe politikës që krijon.

**- LECU me Universitetin e Zurich, Zvicër**

Është mbajtur takimi i katërt me radhë i projektit ndërkombëtar "Learning Cultures in Universities (LECU)" të cilin e udhëheq Universiteti i Cyrihut, derisa edhe Universiteti ''Kadri Zeka'' është pjesë e tij. Në këtë takim që temë diskutimi ka "Competency Oriented Methodology" e i cili po mbahet në Universitetin e Shkodrës, nga UKZ po marrin pjesë Prof. Ass. Dr. Shpresë Qamili dhe Prof. Ass. Dr. Teuta Agaj. Pjesëmarrësit gjatë këtij takimi, kanë diskutuar përvojat e tyre dhe gjetjet aktuale të hulumtimit në arsimin e lartë, të orientuar nga kompetencat duke iu referuar praktikave të përditshme të mësimdhënies në universitetet e tyre.

Projekti "Learning Cultures in Universities (LECU)" është i përqendruar në shkëmbimin e përvojave në mes të institucioneve të arsimit të lartë në Zvicër, Shqipëri dhe Kosovë. Projekti ka për qëllim të promovojë kompetencat në fushën e pedagogjisë në arsimin e lartë.

**Buxheti total i këtyre projekteve që i është sjellë UKZ-së për 2019-2020 është 1,353,018.00 €**

Në kuadër të këtyre projekteve, janë realizuar shumë vizita studimore nëpër universitetet partnere:

- **Dy vizita studimore në Universitetin "Metropolia" Helsinki (7-13.4.2019 dhe 23.8-1.9.2019)**

Ndër aktivitet e Projektit SMAHPC, është realizuar trajnimi/vizita studimore në Universitetin e Metropolias për Shkenca të Aplikuara në Helsinki të Finlandës, ku po merr pjesë një delegacion nga Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan; rektori Bajram Kosumi, Prorektori Dukagjin Leka, Luljete Berisha, Urtak Hamiti dhe Selim Daku.

Projekti në fjalë ka të bëjë me zhvillimin e praktikave profesionale multidisiplinare shëndetësore me metodat më moderne evropiane, me metoda të mësimdhënies të cilat gjejnë zbatim jo vetëm në Finlandë si një ndër shtetet elitë për cilësi në arsim por edhe më gjerë. Për zhvillimin e paketave janë planifikuar 28 punëtori, vizita studimore, konferenca, të cilat do të mbahen në shtetet prej nga vijnë partnerët e projektit dhe të gjitha këto do të realizohen deri në vitin 2021.

Ndërsa vizita e dytë është realizuar ne Gusht të 2019, sërish në të njëjtin Universitet dhe UKZ është përfaqësuar nga: Prorektori Dukagjin Leka, Luljete Berisha, Lulzim Rshiti, Selim Daku, Xhevdet Thaqi dhe Valon Kllokoqi. Kjo ishte Tutoring Ëorkshop mbi mënyrën se si do të dukët qendra multidisiplinare dhe detyrat e përgjegjësitë e saj.

- **Vizita studimore në Universitetin e Manisas, Turqi**

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan Bajram Kosumi, së bashku me prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar Dukagjin Leka, zyrtarja për Bashkëpunim Ndërkombëtar Luljete Berisha, Prof. Merxhan Avdyi, Prof. Nevrje Ismaili dhe prof. Ekrem Alimi kanë qëndruar në Universitetin "Celal Bayar" të Manisas. Kjo vizitë po bëhet në kuadër të projektit SMAHPC – Student-run Multidisciplinary Allied Health Practice Center, i financuar nga Komisioni Evropian në kuadër të programit Erasmus +. Rektori Kosumi në këtë vizitë studimore pos aktiviteteve tjera në kuadër të projektit në fjalë, ka takuar edhe rektorin e Universitetit të Manisas, Kemal Çelebi, me të cilin kanë diskutuar mundësitë e bashkëpunimit edhe përtej projekteve Erasmus+.

Gjatë kësaj vizite do të shihen më për së afërmi përvojat më të mira të ndërlidhjes së punës praktike me teorinë, duke i vendosur studentët në qendër të këtyre aktiviteteve.

Ndryshe, koordinator i projektit SMAHPC – Student-run Multidisciplinary Allied Health Practice Center, i financuar nga Komisioni Evropian në kuadër të programit Erasmus +, është është Kolegji Heimerer, kurse partnerë janë, Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, Metropolia University Finlande, JAMK University Finlande, Manisa University Turki, Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë, MASHT, Instituti i Evropës Juglindore për Politika Shëndetësore dhe Sociale si dhe nga Organizata Joqeveritare Autizmi ne Kosovë.

- **Vizita studimore në Universitetin e Lisbonës, Portugali**

Me një eksperiencë të mirë dhe të qëndrueshme, Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan ka arritur të jetë partner edhe i një projekti tjetër ndërkombëtar bashkë me disa Universitete tjera të Bashkimit Evropian. Kështu, rektori i UKZ-së, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Prorektori për bashkëpunim Ndërkombëtar Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka dhe zyrtarja për marrëdhënie me jashtë Luljete Berisha, po qëndrojnë në Lisbonë të Portugalisë, ku po zhvillohen punimet në kuadër të projektit Erasmus+ e-VIVA.Projekti e-VIVA ka të bëjë me metodat e reja të të mësuarit në Institucionet e Arsimit të Lartë me qëllim të ngritjes së kompetencave dhe njohurive për edukim sa më cilësor.

Objektivat specifike të projektit e-VIVA janë: identifikimi dhe analizimi i qasjeve për aftësim dhe validim të provave për të nxitur përshkueshmërinë midis arsimit të lartë dhe praktikës profesionale; zhvillimi dhe rafinimi i sistemeve të vlerësimit dhe validimit të bazuar në TIK; pasurimi i sistemeve ekzistuese të validimit dhe certifikimit; zhvillimi dhe aplikimi i një softueri të pasur të zhvillimit të kompetencës dhe validimit për shkathtësitë dhe kompetencat e lidhura me shërbimin.

- **Vizita dhe trajnimi në Vjenë, Austri (23-27.10.2019)**

Një delegacion nga Universiteti "Kadri Zeka" po merr pjesë në takimin e menaxhmentit të projektit Eviva në Vjenë. Në këtë trajnim nga UKZ kanë marrë jesë: Prorektori Dukagjin Leka, Selim Daku, Luljete Berisha dhe Lulzim Rashiti. Gjatë trajnimit është diskutuar për të arriturat e projektit e-VIVA, didactic frameëork, sequence pattern, syllabuset, validimi i kompetencave, fokus grupet dhe intervistat e mbajtura, raporti nacional mbi të gjitha të arriturat dhe konferenca e organizuar për këtë projekt në Prishtinë.

- **Vizita dhe trajnimi në Vjenë nga HERAS (31.10.2019)**

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi ka marrë pjesë në punëtorinë e organizuar nga HERAS, në Vjenë të Austrisë. Tema diskutimi në këtë takim ishin: rezultatet e projektit HERAS, diskutimet rreth mësimeve të marra në lidhje me planifikimin, zbatimin dhe qëndrueshmërinë e projektit, diskutimi për strategjinë e qëndrueshmërisë / përdorimit të instrumenteve dhe mjeteve të zhvilluara, gjetjet nga vlerësimi afatmesëm, prezantimi i HERAS Plus, diskutimi mbi përfitimet dhe përvojat e projektit HERAS. Në këtë punëtori kanë marrë pjesë edhe Rektorët tjerë të Universiteteve Publike, përfaqësuesit e MASHT, Drejtori i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës Avni Gashin, kryetari i Këshillit Shtetëror të Cilësisë Gazmend Luboteni si dhe përfaqësuesit e ËUS Austria por edhe ekspertë austriakë.

- **Reflective Workshop SMAHPC, Prishtinë**

Nga datat 3-7 qershor 2019 është mbajtur punëtoria në Kolegjin Heimerer në kuadër të Projektit SMAHPC/ Reflective Workshop.

Në këtë punëtori, ku kanë marrë pjesë të gjithë partnerët kosovarë, partnerët nga Finlanda dhe partnerët nga Turqia. Gjatë këtyre ditëve është diskutuar detajisht paketa punese 2 dhe paketa punese 3, të cilat përfshijnë: kompetencat e mësimdhënies; përmirësimi i qasjeve pedagogjike të Qendrës Multidisiplinare; takimi i menaxhmentit të projektit; konceptet kryesore të projektit, të punuara nga Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar e UKZ-së; dizajnimi i Qendrës Multidisiplinare; si dhe parashikimi i aktiviteteve të radhës dhe ndarja e përgjegjësive të reja për secilin partner.

- **Intervista dhe punëtori me fokus grupe, me biznese që ofrojnë shërbime në Komunën e Gjilanit, në kuadër të projektit e-VIVA (25.9.2019)**

Në kuadër të projektit E-viva, në Universitetin "Kadri Zeka" është mbajtur fokus grupi me disa përfaqësues të bizneseve në Gjilan. Fillimisht prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar Prof. Ass. Dr.

Dukagjin Leka, ka njoftuar të pranishmit me projektin në fjalë, derisa ka falënderuar për pjesëmarrjen në këtë fokus-grup.

Në këtë takim është biseduar në përgjithësi për arsimimin në lidhje me kompetencat që ndërlidhen me shërbimet, e në veçanti për marketingun, mbështetjen e palëve të treta, ofrimin e edukimit rreth kompetencave që ndërlidhen me shërbimin, metodologjinë dhe Kompetencat e ndërlidhura me shërbimin dhe Validimin.Projekti E-viva është një projekt i financuar nga Erasmus + me 16 partnerë, për një kohëzgjatje prej tre vjetësh.

- **Konferenca e bashkë organizuar me Kolegjin Universum për të arriturat e projektit e-VIVA (23.12.2019)**

Në Kolegjin "Universum" u mbajt konferenca për njoftimin e publikut të gjerë rreth projektit e-VIVA, pjesë e të cilit janë Universiteti "Kadri Zeka" dhe Kolegji "Universum". Duke sjellë risi në fushën e arsimit në Kosovë, Projekti e-VIVA adreson çështjet që synojnë të punojnë në industrinë e zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve. Pjesë e kësaj konference përveç përfaqësuesve të institucioneve përkatëse ishin të ftuar mysafir si: Ministri i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit, Muzafer Shala, profesorë, studentë dhe media.

Projekti synon të evidentojë kompetencat më themelore për ekonominë e shërbimeve dhe do të kontribuojë në transparencë më të lartë të tyre, për studentët, mësuesit dhe punëdhënësit. Projekti është i financuar nga programi ERASMUS + i Bashkimit Evropian dhe synon të kontribuojë në avancimin e mëtutjeshëm të mënyrave të reja të të mësuarit në universitete vendore.

Dukagjin Leka, prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Universitetin "Kadri Zeka" specifikoi se krahas partnerëve të shumtë ndërkombëtar që kanë përfituar nga ky projekt, partnerët e vetëm nga Kosova janë Kolegji "Universum" dhe Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, Gjithashtu shtoi se ndonjëherë me pak para mund të bëjmë ndryshime të mëdha.

Drejtori i Kolegjit "Universum", Alejtin Berisha, potencoi se Universum është një ndër institucionet në Kosovë që më së shumti ka bashkëpunime ndërkombëtare me universitete evropiane. Ndër të tjera, ai falënderojë Universitetin "Kadri Zeka" për punën e përbashkët dhe tha se shpresojnë që edhe në vazhdim të bashkëpunojnë në projekte të tilla.

Në kuadër të thirrjes së fundit, në 2020, UKZ ka aplikuar me 18 projekte në ngritjen e kapaciteteve:

- Dy projekte mbi ngritjen e kapaciteteve si koordinator:

"Digital Solution Technology / DiSoTec"

"Master in Mediation in Kosovo and Albanian's HEIs/LEAD"

- 16 si partnerë

**ICM- Mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik**

UKZ ka nënshkruar Marrëveshje për mobilitet të stafit dhe studentëve në kuadër të Erasmus + KA107 me:

- **Universitetin e Ruses, Bulgari**

Universiteti "Kadri Zeka" ka nënshkruar Marrëveshje për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve me Universitetin e Ruses në Bullgari. Kjo marrëveshje u mundëson stafit dhe studentëve të të dy universiteteve shkëmbim apo qëndrim në njërin universiteti për 1 deri në 3 muaj ose një semestër të plotë. Kjo marrëveshje është në kuadër të ICM Erasmus +, e cila financohet komplet nga EACEA. Fushat e aplikimit janë programet e studimit të cilat UKZ i ofron studentëve të saj.

- **Universitetin e Manisas, Turqi ku përfshihet mobiliteti në universitete në Azerbajxhan, Tunisi, Keni dhe Algjeri**

Projekti me Universitetin e Manisas KA-107 është aprovuar nga Agjencia Nacionale e Turqisë. Ky projekt hynë në kuadër të Programit Erasmus + KA107, Interantional Credit Mobility, në të cilin projekt, Universiteti "Kadri Zeka", së bashku më Universitetin e Manisas "Celal Bayar", Azerbaijan Khazar University, Algeria Universite D'Alger 2, Kenya University, Sfax University in Tunisia kanë fituar projektin për shkëmbime afatshkurtra për studentët dhe stafin akademik.

Projekti me numër "2019-1-TR01-KA107-073710", përfshinë 56 mobilitete në shumë prej 162.980 €, i cili do të zgjasë tri vite, pra deri më Korrik 2022.

- **Universitetin Alma Matter Europaea, Slloveni**

Një Marrëveshje e re mbi shkëmbimin e stafit dhe studentëve është nënshkruar mes të UKZ dhe Universitetin Alma Matter Europeae në Slloveni. Edhe kjo Marrëveshje është në kuadër të Erasmus + ICM.

**Marrëveshje bashkëpunimi:**

UKZ ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me Institucione të ndryshme

- **Marrëveshje bashkëpunimi me Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport (21.2.2019)**

Është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të UKZ-së dhe Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti, me të cilin, rektori Bajram Kosumi, nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e Programit Nacional për Rininë.

Programi Nacional për Rininë është hartuar për të gjithë nxënësit dhe studentët e Republikës së Kosovës dhe ka për qëllim ta bëjë më atraktiv mësimin dhe të nxjerrë talent. Në kuadër të këtij programi do të organizohen gara në tri fusha kryesore: dituri, kreativitet kulturor dhe mendim kritik si dhe në sport. Për të tria fushat janë përgatitur udhëzuesit për rrjedhën e garës.

- **Marrëveshje bashkëpunimi me S.T.A (18.3.2019)**

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan Bajram Kosumi bashkë me Prorektorin Dukagjin Leka, kanë pritur në takim përfaqësuesit e S.T.A (Country Master Distributor for ETS).

Me këtë rast Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan Bajram Kosumi dhe Përfaqësuesja e Përhershme e S.T.A (Country Master Distributor for ETS), Ines Dika, kanë nënshkruar Protokoll Bashkëpunimi.

Kjo marrëveshje ka për qëllim që të garantojë bashkëpunimin midis UKZ dhe S.T.A, me qëllim sigurimin e standardit gjatë procesit të testimit të gjuhës Angleze e Frënge dhe të garantojë certifikimin zyrtar të rezultatit të arritur gjatë testimit në ambientet e UKZ-së. Sipas marrëveshjes S. T.A do të testojë studentët e UKZ-së dhe jo vetëm, në formatin "paperbased" që janë për gjuhën angleze, përkatësisht 2 (dy) variantet e testeve, TOEFL ITP® dhe TOEIC® L&R dhe për Gjuhën Frënge, përkatësish testi TFI™. Të tre testet janë të akredituara nga CEFRL si teste të standardizuara për njohjen e gjuhës angleze dhe frënge.

- **Marrëveshje bashkëpunimi me Cacttus (20.05.2019)**

Me qëllim të promovimit të bashkëpunimit në ngritjen profesionale të studentëve, UKZ ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me Cacttus. Sipas marrëveshjes, Cacttus do të pranojë një numër të caktuar të studentëve të UKZ-së që të kryejnë praktikën profesionale, atëherë kur Cacttus ka hapësirë për angazhimin e studentëve në punë praktike.

Ky bashkëpunim ka për qëllim t'iu sjellë dobi studentëve, duke i pajisur me shkathtësi që ua lehtësojnë inkuadrimin në tregun e punës. Kjo marrëveshje do të ketë si synim, zhvillimin e shkathtësive teknologjike si dhe shkathtësi të tjera që ndikojnë në zhvillimin e kuadrove të reja. UKZ, pas kryerjes dhe prezantimit të suksesshëm të punës praktike, do t'i akumulojë studentit numër të caktuar të ECTS/ kredi, në kuadër të lëndës PROJEKTI, sipas Rregullores për Studime Baçelor në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike

Kjo marrëveshje bashkëpunimi paraqet vetëm hapin e parë drejt krijimit të një të ardhme, të orientuar nga teknologjia e informacionit, për të mirën e studentëve.

- **Marrëveshje bashkëpunimi me Kolegjin Heimerer (13.06.2019)**

Duke marrë parasysh bashkëpunimin e mirë në kuadër të Projektit SMAHPC, si vazhdimësi e bashkëpunimit të tillë mbi dobitë e shkëmbimit të stafit akademik, studentëve dhe të eksperiencave ndërmjet dy institucioneve të arsimit të lartë, është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet UKZ dhe Kolegjit Himerer.

Kjo marrëveshje ka për qëllim promovimin e një ambienti akademik më dinamik dhe përgatitjes së gjeneratave të ardhshme të profesionistëve në fushën e shkencave shëndetësore terapeutike dhe ndërlidhjes së tyre me shkencat tjera të duke përfshirë teknologjinë informative, inovacionin dhe ndërmarrësin. Universiteti Publik "KADRI ZEKA" dhe Kolegji Heimerer pajtohen që të organizojnë bashkërisht trycza shkencore, shkëmbim të përvojave, organizime të garave të diturisë në mes të dy institucioneve, si ligjërata dhe trajnime të hapura me tema aktuale për studentët e IAL-ve.

Universiteti Publik "KADRI ZEKA" dhe Kolegji Heimerer gjithashtu janë marrë vesh që të organizohen në përgatitjen e dokumentacionit për pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare.

- **Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Ruses, Bullgari (9.7.2019)**

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, anëtari i Këshillit Drejtues Prof. Ass. Dr. Musa Ajeti dhe prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka, kanë realizuar një vizitë zyrtare në Bullgari, respektivisht në Universitetin "Angel Kanchev" Ruse.

Me këtë rast, është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në mes të dy universiteteve. Drejtuesit e Universiteteve në fjalë janë shprehur të kënaqur me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, derisa kanë vlerësuar se një bashkëpunim i ndërsjellët është mjaft i rëndësishëm për të dyja Institucionet, derisa e kanë vlerësuar shumë të dobishëm dhe se do të kontribuonte në zhvillimin e arsimit në Ballkan.

- **Marrëveshje bashkëpunimi me Caritas Zviceran (15.7.2019)**

Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan (UKZ) dhe Caritasi Zviceran (CaCH) kanë arritur memorandum mirëkuptimi për bashkëpunimin dhe zbatimin e aktiviteteve në Fakultetin e Edukimit në kuadër të projektit "Vendosja e Standardeve Parashkollorë të Cilësisë së Lartë duke Përforcuar Arsimin, Shkencën dhe Ekonominë" (SHPRESE). Marrëveshjen e kanë nënshkruar Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në

Gjilan, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, ndërsa në emër të Caritasit zviceran Kreshnik Basha, zëvendësdrejtor për Kosovë dhe Prof. Asoc. Dr. Januz Dervodeli, dekan i Fakultetit të Edukimit.

Projekti ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe ofrimit të shërbimeve në arsimin para fillor në Kosovë. Meqenëse një ndër objektivat e projektit ndërlidhet me Fakultetet e Edukimit në Kosovë, gjegjësisht për programet parafillor, UKZ respektivisht Fakulteti i Edukimit nga projekti në fjalë do të organizojë trajnime për personel akademik të UKZ, praktikë me pagesë për studentët tanë, klasë praktike në UKZ si model për programin parashkollor, do të bëhet rishikim i syllabuseve, si dhe do të ofrohen mbështetje të tjera sipas kërkesës së Fakultetit të Edukimit në Gjilan me qëllim të përfitimit të Fakultetit të Edukimit nga ky projekt.

- **Marrëveshje bashkëpunimi dhe protokoll i veçantë për mobilitetin e studentëve me Universitetin e Zug, Zvicër (16.12.2019)**

Një delegacioni i Universitetit "Kadri Zeka", në përbërje të rektorit, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, prorektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka, zyrtarja për marrëdhënie me jashtë z. Luljete Berisha dhe 17 studentët e Universitetit tonë, kanë vizituar zyrtarisht Universitetin Zug të Zvicrës.

Delegacioni i UKZ-së së bashku me studentët, janë pritur në një takim nga Prof. Dr. Esther Kamm, Rektore e Universitetit ZUG, e cila ka falënderuar studentët e UKZ-së që kanë pranuar të qëndrojnë për vizitë studimore në Universitetin ZUG . Kurse nga ana e tij Rektori Kosumi ka falënderuar Rektoren Kamm për pritjen, duke thënë se studentët janë urë lidhëse e bashkëpunimit mes dy institucioneve.

Rektori, Kosumi nënshkroi dy marrëveshje me Rektoren, Prof. Dr. Esther Kamm. Po ashtu, kryetari i qytetit të Zugut, z. Karl Kobelt pati një prezantim para studentëve tanë. Shumë pyetje dhe diskutime u bënë mes studentëve të UKZ-së dhe kryetarit dhe rektorëve.

- **Marrëveshje bashkëpunimi me Kolegjin IBCM Mitrovicë (14.11.2019)**

Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan (UKZ) dhe International Business College Mitrovica (IBC-M) kanë nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi. Dy drejtuesit e Institucioneve janë zotuar që të bashkëpunojnë për zhvillim në fushën e arsimit në Republikën e Kosovës, kërkimit akademik, aktiviteteve studentore, dhe programeve relevante për komunitetin.

Objektiva kryesore e këtij Memorandum Mirëkuptimi është nxitja e bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes partnerëve në aktivitetet që mbështesin jetën akademike dhe komunitetin në Kosovë, përfshirë: shkëmbimin akademik, ligjëratat ftuese nga profesorët vizitues; ofrimin e vlerësimeve të jashtme për aktivitetet e përzgjedhura akademike/profesionale në IBC-M; bashkëpunimin në zhvillimin e përbashkët të projekteve mes ligjëruesve dhe menaxhmentit të institucioneve partnere; bashkëpunimin në projekte ndërkombëtare si Erasmus+, Horizon 2020, IPA, HERAS, etj.; shkëmbimin e informacioneve shkencore dhe teknike; zhvillimin e përbashkët të aktiviteteve profesionale përfshirë kërkimin, trajnimet, punëtoritë,

seminaret dhe konferencat; bashkëpunimin në zhvillimin e programeve të reja dhe trajnimit që i shërbejnë komunitetit; realizimin e programeve të përbashkëta hulumtuese nga studentët si dhe shkëmbimi në fushë e aktiviteteve sportive dhe grupeve kulturore.

- **Marrëveshje bashkëpunimi me Alma Mater Europaea University, Slloveni (5.12.2019)**

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka", Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi dhe Presidenti i Universitetit Alma Mater Europaea Profesor Dr. Ludvik Toplak, në Maribor të Sllovenisë, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi mes dy institucioneve që ata drejtojnë. Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të ndihmojë suksesin e Universiteteve në programin Erasmus +, si dhe fushave të tjera. Të dy drejtuesit e Universiteteve kanë thënë që institucionet e tyre të arsimit të lartë njohin vlerën e bashkëpunimit ndërkombëtar, dhe dëshirojmë të lejojmë studentët të zgjerojnë dhe përsosin njohuritë e tyre përmes programeve tona të studimit.

- **Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Elbasanit (10.12.2019)**

Një delegacion nga Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, i kryesuar nga rektori Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, ka qëndruar në Elbasan, ku ka marrë pjesë në shënimin e 110 vjetorit të Shkollës Normale të Elbasanit. Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan Bajram Kosumi dhe Rektori i Universitetit "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, Skënder Topi, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi mes dy institucioneve që ata drejtojnë.

Marrëveshja në fjalë, përpos tjerash, parasheh mundësinë e bashkëpunimit për programe studimore të përbashkëta, zhvillim të mobilitetit sikurse për stafin akademik po ashtu edhe për studentët, si dhe bashkëpunimi sa i përket projekteve ndërkombëtare.

- **Marrëveshje bashkëpunimi me HEPIA University, Gjeneve, Zvicër (30.12.2019)**

Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, e ka përmbyll vitin 2019 me një sukses të ri. Kështu, në vazhdimin e aktiviteteve të një pas njëshme që UKZ ka pasur gjatë vitit 2019, ka arritur të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi edhe me Geneva University of Applied Sciences Ëestern Sëitzerland technology, architecture and landscape – Hepia. Sipas marrëveshjes në fjalë, Universiteti ynë dhe Hepia', do të bashkëpunojnë në suaza të arsimimit të standardeve bashkëkohore e ndërkombëtare. Ndër të tjera, palët nënshkruese sipas kësaj marrëveshjeje, kanë rënë dakord të angazhohen në projekte të përbashkëta kulturore dhe kërkimore e shkencore si dhe organizimin konferencave të përbashkëta

- **Zgjerohet pilotprojekti i UKZ-së "Më shumë se një mësues për ciklin fillor"**

Që nga shtatori 2019, kur edhe ka filluar viti i ri shkollor, nismës së Universitetit "Kadri Zeka" të pilotprojekti "Më shumë se një mësues për ciklin fillor", e që është mbështetur nga GIZ dhe Komuna e Gjilanit, respektivisht Drejtoria për Arsim, i janë bashkangjitur edhe tri shkolla fillore të kësaj komune, " Musa Zajmi", "Abaz Ajeti" dhe "Rexhep Elmazi", për klasat e treta, katërta dhe të pesta, derisa shkolla "Selami Hallaqi" ka filluar që nga viti i kaluar.

Universiteti "Kadri Zeka", ka qenë vazhdimisht i kyçur edhe në shkollimin fillor, përmes formave të ndryshme, qoftë të këshillimeve, propozimeve, mbështetjes profesionale, në mënyrë që të zhvillohen reformat që bëjnë ndryshime dhe ndikojnë direkt në rritjen e cilësisë dhe sukseseve të nxënësve.

Për të parë punën e ecurisë së pilot projektit, "Më shumë se një mësues për ciklin fillor", drejtues të UKZ-së, prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar Dukagjin Leka, profesorët e Fakultetit të Edukimit Nevrije Ismaili dhe Mensur Neziri, kanë vizituar shkollat e lartpërmendura veç e veç, ku kanë pasur takime me drejtuesit e tyre dhe me mësimdhënësit, njëherësh kanë marrë pjesë nëpër klasat që është duke u zhvilluar pilotprojekti. Dukagjin Leka, prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar, në Universitetin "Kadri Zeka", në emër të rektorit Bajram Kosumi ka uruar të gjithë për fillimin e implementimit të pilotprojektit, derisa ka thënë se universiteti do të jetë vazhdimisht i kyçur edhe në shkollimin fillor, përmes formave të ndryshme, qoftë të këshillimeve, propozimeve, mbështetjes profesionale, në mënyrë që të zhvillohen reformat që bëjnë ndryshime dhe ndikojnë direkt në rritjen e cilësisë dhe sukseseve të nxënësve.

Nga ana e tyre, drejtorët e shkollave fillore, ku po zhvillohet pilotprojekti "Më shumë se një mësues për ciklin fillor", janë shprehur se mësimdhënësit në përgjithësi kanë qenë të vendosur që këtë praktikë të re e cila është ende pilot projekt ta shndërrojnë në një sukses që do të merret model për shkollat e Gjilanit dhe gjithë Kosovës, dhe se sipas tyre kjo qasje është pranuar mjaft mirë dhe nga ana e nxënësve.

Angazhimi i mësimdhënësve në një apo dy lëndë është një profesionalizëm më i lartë dhe njëkohësisht, zhvillimi i qëndrueshëm i fëmijëve në moshën e hershme, në aspektin e nxënies së diturive me këtë model të përfshirjes së më shumë mësimdhënësve, mund të sjellë rezultate që do të shihen gjatë së ardhmes.

Drejtorët e shkollave, besojnë se ky pilot projekt do të jetë i suksesshëm, gjithnjë në favor të cilësisë në arsim, por dhe njëkohësisht, edhe të përgjegjësisë më të madhe dhe mundësisë e të nxënit në një nivel më të lartë, pasi që secili mësimdhënës është përgjegjës për një lëndë mësimore, , sepse një mësues, sado i përgatitur, nuk do të mund të jetë i efektshëm në të gjitha lëndët për të gjitha nivelet e mësimit klasor.

Implementimit të pilot projektit që ka për qëllim ngritjen e cilësisë të këtij niveli të arsimit, i kanë paraprirë organizimi i tryezave debatuese nga Universiteti "Kadri Zeka", janë mbajtur diskutimet të ndryshme, janë bërë hulumtime dhe njëherësh janë konsultuar ekspertë të fushave përkatëse.

**Anëtarësimet në organizata ndërkombëtare**

UKZ është bërë anëtare e disa organizatave të ndryshme ndërkombëtare:

- **Asociacioni i Fakulteteve Juridike Evropiane ELFA (24.12.2019)**

Nga 1 janari 2020, Fakulteti Juridik bëhet pjesë e Asociacionit Evropian të Fakulteteve Juridike (European Laë Faculties Associaton-ELFA). Nga sekretariati i ELFA-s dhe në emër të Presidentit të këtij Asociacioni, Prof. Dr. Marek Grzyboëski më është konfirmuar se Bordi i Drejtorëve të ELFA-s ka votuar unanimisht për pranimin tonë, si dhe ka konfirmuar se anëtarësimi bëhet fuqiplotë nga 1 janari 2020. Anëtarësimi në ELFA nënkupton shumë mundësi në të ardhmen për Fakultetin Juridik të UKZ-së, për personelin e këtij fakulteti e në veçanti për studentët.

- **UKZ është bërë anëtare e Konferencës së Rektorëve të Universiteteve të Evropës Juglindore në Universitetin e Podgoricës, (24.4.2019)**

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Bajram Kosumi me një delegacion, kanë marrë pjesë në Forumin e katërt të Rektorëve të Universiteteve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor që u mbajt në Podgoricë, respektivisht në Universitetin e Malit të Zi.

Me këtë rast, Universiteti "Kadri Zeka" është bërë anëtar i Forumit të Rektorëve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor. Ndërkohë, në këtë Forum kanë marrë pjesë rektorë dhe përfaqësues të rreth 30 njësive universitare, të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor.

- **Sustainable Development Solutions Netëork, nën patronazhin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (26.6.2019)**

Komiteti Ekzekutiv i Rrjetit të Zgjidhjeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDSN), e cila është një Iniciativë Globale e Kombeve të Bashkuara, ka pranuar Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan, si anëtare në Rrjetin e Rrjetave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar Dukagjin Leka, ka thënë se jemi shumë të lumtur që Universiteti ynë i është bashkuar SDSN, derisa thotë se presim të punojmë të gjithë së bashku në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm.

Si një anëtare e SDSN, Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan do të ketë qasje të privilegjuar në platformën e komunikimit online SDSN Mobilize, që mundëson identifikimin dhe lidhjen me ekspertë të tjerë të zhvillimit të qëndrueshëm, njëherësh ofron mundësinë e promovimit të aktiviteteve dhe ngjarjeve, për perspektiva të reja në fushën e bashkëpunimit dhe shumë më tepër!

- **Universiteti "Kadri Zeka" bëhet partner edukativ i kompanisë Microsoft (28.1.2019)**

Studentët dhe i gjithë stafi i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan tani e tutje do të kenë qasje në produktet më të fundit të Microsoft si sistemet operative, softuerin e serverëve, programet aplikative dhe edukative, dokumentacionin dhe referencat teknike.

Microsoft Imagine është një platformë e licencimit të softuerëve për universitet dhe kolegjet që mësojnë dhe shfrytëzojnë teknologjinë. Kjo nënkupton legalizimin e përdorimit të shfrytëzimit të të gjitha programeve (sistemeve operative dhe aplikacioneve) nga ana e stafit akademik dhe administrativ apo mund të përfitojmë nga ndalimi i pagesave të mëtejme për shfrytëzimin e kufizuar të këtyre produkteve. Stafi akademik, administrativ dhe studentët, përfitojnë mundësinë për të shkarkuar dhe shfrytëzuar sisteme operative, aplikacione dhe programe tjera të natyrës akademike pa pasur nevojë për pagesa shtesë. Për këtë, punën teknike e ka realizuar Refik Ramadani Asistent në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Ilir Halili Student ne studimet master E-Qeverisje. Ndërsa donacionin e ka mundësuar kompania "Vali Ranch" nga Gjilani. Është një listë e gjerë e programeve dhe aplikacioneve që mund ti gjeni në linkun më poshtë:

Linku:

https://e5.onthehub.com/webStore/Account/AccountDetailsRegistration.aspx?u=4bf99d8d-1cf3-c811-810c-000d3af41938&uv=4df99d8d-1cf3-c811-810c-000d3af41938&token=Aëio1kREX9E9HyuMqyIXqJdsiCS2Lcgq%2frJrGay2JëYrXS7K25%2fsYm64%2bec4MPIKF3ABqfI9CYJ8klUMDbimFMMëAuSa%2fotgchg%3d&ës=eb7ecfae-ac8b-e011-969d-0030487d8897

**Info Day- Ditët informuese**

Në UKZ janë mbajtur edhe ditët informuese për programe të ndryshme, siç janë:

- **Erasmus + Main Info Day (31.10.2019) dhe UKZ si Best Practices**

Në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë, është mbajtur dita kryesore informuese e Zyrës së Erasmus + në Kosovë mbi shpalosjen e programit dhe thirrjes së radhës nga EACEA. Në kuadër të këtij sesioni, kanë marr pjesë të gjitha Institucionet e publike dhe private të Arsimit të Lartë në Kosovë, përfaqësues nga MASHT si dhe studentë. Ky sesion informues ka qenë tejet i rëndësishëm për UKZ-në pasi që Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka ka qenë i ftuar të bëjë prezantimin në sesionin e Best Practices, ku është bërë një prezantim i detajuar i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve dhe projektit QUADIC si koordinator.

- **Erasmus + Info Day (07.11.2019)**

Në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan është mbajt dita informuese për thirrjen e radhës për ERASMUS + 2020. Këtë organizim, ku ishin të pranishëm Rektori, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, stafi akademik, administrativ dhe studentët, e hapi Prof. Ass. Dr. Dukagjn Leka, i cili falënderoi përfaqësuesit e Zyrës së ERASMUS + për mundësit e ofruara. Më pas Koordinatorja e Zyrës Erasmus+ në Kosovë, Jehona Lushaku dhe asistentja, Blerinë Zjaça, për stafin akademik dhe studentët, kanë dhënë informacione të detajuara se si të aplikojnë për Shkëmbime afatshkurtëra/ International Credit Mobility (ICM);Master të përbashkët/ Erasmus Mundus Joint Master Degrees (EMJMDs); Projekte për ndërtimin e kapaciteteve në Arsimin e Lartë/ Capacity Building for Higher Education (CBHE);Projekte për Jean Monnet/ Jean Monnet Actions (JMA).

Kurse nga zyrtarja për Bashkëpunim Ndërkombëtar e UKZ-së, Luljete Berisha, pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen përmes prezantimit, për projektet e suksesshme nga e kaluara, mobilitetet dhe marrëveshjet ndërkombëtare që UKZ ka me Universitetet e vendeve të BE. Ky aktivitet ka për qëllim shpërndarjen e informatave për rregullat dhe procedurat e aplikimit në Programin Erasmus+. Zyra e Erasmus+ synon të rrisë pjesëmarrjen e IAL në Kosovë në programin Erasmus+

- **Info Day nga Ambasada Franceze në Kosovë rreth mundësisë së studimit në Francë (07.10.2019)**

Në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan u mbajt konferenca « Të studiosh në Francë », qëllim i së cilës ishte të informojë studentët për mundësitë që ka në dispozicion Franca për të studiuar.Konferencën e hapi Dukagjin Leka, profesor i Universitetit "Kadri Zeka" i cili falënderoi organizatorët, Aleancën Franceze në Prishtinë dhe Ambasadën e Francës në Kosovë për prezantimin rreth studimeve në Francë, deri sa inkurajojë të gjithë të interesuarit që të shfrytëzojnë këtë mundësi, pavarësisht nivelit të frëngjishtes që kanë.Kurse ztr. Joseph Giustiniani, atashe për bashkëpunim me Ambasadën e Francës në Kosovë dhe znj. Zana Latifi, përgjegjëse e Camups France në Aleancën Franceze, informuan për mundësitë e bursave, shkëmbimeve, kushteve të regjistrimit dhe jetën e studentore në Francë.Ndryshe, vendet frankofone janë destinacionet kryesore për arsim universitar. Universitetet franceze janë ndër më të mirat dhe më prestigjiozët në botë.

- **Info Day për studentët projektin e USAID "Up to youth" (07.11.2019)**

Në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan u bë prezantimi i projektit "UP TO YOUTH" i cili financohet nga USAID dhe është i shtrirë në 9-të komuna të Republikës së Kosovës, ku do të angazhon rreth 40 të rinj.

Projekti "Up Up Youth" i financuar nga USAID funksionon me të rinjtë e Kosovës nga mosha 16-24 vjeç të cilët janë të prekshëm nga përjashtimi social, duke i mobilizuar dhe fuqizuar ata për një ndikim pozitiv në shoqëri. Projekti synon rininë e margjinalizuar, veçanërisht ata të nënvlerësuar nga iniciativat kapitale, me stres dhe traumë të pa adresuar, ose të prekshme nga zhvillimi i sjelljeve të rrezikshme. Programi

punon për ndërtimin e aseteve dhe agjencive rinore, duke mundësuar të rinjtë të kontribuojnë dhe luajnë role udhëheqëse në komunitetet e tyre, duke ndërtuar dhe mbështetur rrjete dhe një mjedis që ofron mundësi për zhvillim pozitiv të të rinjve.

Qëllimi i projektit është të ndikojë pozitivisht te të rinjtë, të cilët nën moshën 24 vjeç përbëjnë 42% të popullsisë së Kosovës, nga ta 52% janë të pa punë dhe 30% i takojnë ekonomisë joformale. Duke u mbushur me ambicie dhe dëshirë për t'u integruar plotësisht në ekonominë globale, ndërsa janë të irrituar nga mundësitë që kanë në dispozicion, rinia do të luajë një rol kryesor në përcaktimin e të ardhmes politike dhe ekonomike të Kosovës, dhe zëri juaj të dëgjohet

**Vizita në UKZ dhe jashtë saj**

- **Rektori Kosumi ka marr pjesë në Samitin Botëror të Paqes 2019 në Seul të Koresë së Jugut (10.2.2019)**

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" Prof. asoc, dr. Bajram Kosumi ka marrë pjesë në WORLD SUMMIT 2019 të organizuar nga UNIVERSAL PEACE FEDERATION, që është mbajtur në Seul të Koresë më 7-11 shkurt, me temë "Paqja, siguria dhe zhvillimi njerëzor".

Në Samit kanë marrë pjesë liderë të shquar botërorë, të tashëm dhe të shkuar, si Fatmir Sejdiu- president i Kosovës, Alfred Moisiu- presidenti i Shqipërisë, Stipe Mesiq-president i Kroacisë, Dik Çejni-nënkryetar i SHBA-ve, Hoze Barroso-kryetar i Komisionit Evropian, Zhivko Budimir-president i Bosnjës dhe Hercegovinës, Albin Kurti, deputet, si dhe një numër i madh i ish presidentëve, ish kryeministrave, deputetëve dhe liderëve të tjerë nga të katër anët e botës. Rektori Kosumi në fjalimin e tij diskutoi rrezikun nga mos-zgjidhja e konflikteve lokale, të cilat mund të shndërrohen në kriza globale dhe ta rrezikojnë paqen globale. Ai theksoi përvojën pozitive të Kosovës, nga një krizë lokale e shndërruar në krizë global, e që me ndihmën e NATO-s, SHBA-ve dhe të shteteve të forta evropiane e botërore u orientua në rrugën e drejtë të lirisë, pavarësisë dhe të demokracisë.

- **Vizita në PH Zug (15.9.2019)**

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, së bashku më prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka, kanë realizuar një vizitë zyrtare në Zvicër, respektivisht në Universitetin ZUG. Ata kanë pasur takime të shumta atje, ku ndër tjerash kanë zhvilluar takim me rektori i PH Zug, Prof. Esther Kamm dhe Prorektori, Prof. Clemens Diesbergen, nga zyra për bashkëpunim ndërkombëtar në PH Zug si dhe me zyrtarë të tjerë. Qëllim i këtij takimi është shikimi i hapave të mëtutjeshëm në thellimin e bashkëpunimit mes UKZ dhe ZUG, përkatësisht, ripërtëritjen e marrëveshjes mes dy institucioneve, shkëmbimin e studentëve kosovar dhe atyre zviceran, etj.

Ndryshe, dy vitet paraprake, në 2017 dhe 2018, rreth 20 studentë të Universitetit ZUG, kanë qëndruar në UKZ, si rrjedhojë e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit mes rektori të UKZ-së Bajram Kosumi dhe rektores së Universitetit të ZUG-ut, Brigit Eriksson – Hotz, në muajin mars 2017.

Një mobilitet i tillë do të realizohet edhe këtë vit mes studentëve të ZUG dhe atyre të UKZ-së në muajin tetor, respektivisht dhjetor 2019.

- **Vizita njëjavore e studentëve të Universitetit të Zug në UKZ (7-13.10.2019)**

14 studentë të Universitetit të ZUG në Zvicër kanë qëndruar në Gjilan, ku janë pritur nga profesori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan Dukagjin Leka, zyrtarja për marrëdhënie me jashtë Luljete Berisha dhe studentët mikpritës të UKZ-së, tek të cilët do të qëndrojnë studentët zviceran. Kjo vizitë është si rrjedhojë e marrëveshjes së bashkëpunimit që Universiteti "Kadri Zeka" ka me Universitetin ZUG, në këmbim të mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve.

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, ka pritur në një takim disa student të Universitetit ZUG të Zvicrës, të cilët janë duke qëndruar në UKZ për një vizitë studimore. Ai ka theksuar se studentet në këtë mënyrë të vizitave, përfitojnë përvoja të rëndësishme dhe do të kenë mundësi të zhvillojnë një sërë aktivitetesh, andaj ka ftuar që të shfrytëzojnë sa më shumë këtë eksperiencë studentore.

Më pas studentët zviceran kanë zhvilluar një takim me dekanin e Fakultetit të Edukimit Prof. Ass. Dr. Merxhan Avdyli, si dhe stafin akademik të këtij fakulteti, të cilët kanë bashkëbiseduar rreth fushës së edukimit dhe mësimdhënies edukative. Ndërsa Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka, asistenti Selim Daku, si dhe zyrtarja për Bashkëpunim Ndërkombëtar Luljeta Berisha, bashkë me studentët zviceran dhe studentët gjilanas, kanë zhvilluar punëtorinë e përbashkët me temë "Roli i mësuesve në shkollë dhe shoqëri".

Më pas studentët e Universitetit të ZUG, kanë marrë pjesë në një orë të ligjëratës së lëndës *Shkrim akademik* te Prof. Ass. Dr. Mexhan Avdyli, ligjëruesit të lëndës së *Artit figurativ*, Ahmet Ibrahimi dhe në një orë të lëndës së *Artit muzikor* të ligjërueses Drita Kryeziu, për të parë konkretisht se si zhvillohet procesi mësimor në UKZ. Studentët si: Jana, Carmela, Sabine, Naomi, Anna, Julia, Frederic, Rebekka dhe Dominique, janë shprehur të entuziazmuar me procesin mësimor të UKZ-së. Ata kanë thënë se asgjë sa i përket mësimdhënës nuk e dallon Universitetin e ZUG-ut me këtë të UKZ-së. Sipas tyre, relacioni mësimdhënës-studentë në Universitetin "Kadri Zeka' është i shkëlqyeshëm.

Studentët e Fakultetit të Edukimit të Universitetit ZUG të Zvicrës të cilët po qëndrojnë në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan për një vizitë studimore, sot kanë vizituar komunën e Gjilanit ku janë pritur nga kryetari i Komunës, Lutfi Haziri. Kryetari Haziri i ka informuar ata për historikun e Gjilanit, traditat, bashkëjetesën mes komuniteteve, sistemin politik, dhe për sfidat e prioritetet që ka Gjilani dhe Kosova në përgjithësi. Kreu i Gjilanit i është përgjigjur interesimeve të studentëve të pranishëm nga ky universitet, teksa ka thënë se, në veçanti, kjo komunë është shembull i tolerancës dhe bashkëjetesës me të gjitha komunitetet.

Ndërkaq ditëve në vijim, në vizitën e tyre studimore, studentët e Universitetit ZUG të shoqëruar edhe nga studentët e Universitetit "Kadri Zeka" gjatë qëndrimit pesëditor, kanë pasur aktivitete të përbashkëta, takime me menaxhmentin e UKZ-së, kanë vizituar komunën disa shkolla fillore dhe institucione parashkollore në Gjilan.

Po ashtu në kuadër të kësaj vizite janë mbajtur edhe dy punëtori: punëtoria me temë "Roli i mësuesve në shkollë dhe shoqëri"

Punëtoria për "Përdorimin dhe integrimin e mediave dixhitale".

Studentët zviceran kanë qëndruar nëpër familjet shqiptare, respektivisht nëpër familjet e studentëve tanë, për të mësuar më shumë për sistemin arsimor, për kulturën shqiptare, për traditat tona dhe në përgjithësi për jetën kosovare.

- **Vizita në EULEX (24.03.2019)**

Për herë të parë rreth 40 studentë nga Universiteti "Kadri Zeka" kanë vizituar selinë e EULEX-it.

Gjatë këtij organizimi, përfaqësues të EULEX në Prishtinë, kanë prezantuar mandatin e ri të tyre si dhe kanë njoftuar studentët rreth punës dhe arritjeve dhjetë vjeçare në Kosovë.

Studentët e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan të cilët ishin të udhëhequr nga prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe zyrtarja për marrëdhënie me jashtë, gjatë kësaj vizite, gjithashtu kanë pasur rastin të njihen në mënyrë interaktive për mandatin e ri të EULEX-it dhe për punën e këtij misioni në përkrahje të institucioneve të Kosovës për sundimin e ligjit.

Kjo është hera e parë që një institucion vendas i arsimit të lartë e viziton misionin EULEX në Prishtinë.

- **Vizita nëpër universitete publike në Kosovë për Projektin e HERAS dhe QUADIC (11.10.2019)**

Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar Dukagjin Leka dhe Luljete Berisha kanë realizuar një vizitë nëpër disa universitete publike ne Kosovë: Universitetin e Mitrovicës, Universitetin e Pejës dhe Universitetin e Gjakovës për të shikuar për së afërmi të arriturat e projektit Heras Programmatic Project "Internationalization of HEI and project writing".

Në Universitetin e Mitrovicës, takimi u realizua me Prof. Besart Hajrizi, përgjegjës për bashkëpunim ndërkombëtar. Vizita vazhdoj në Universitetin e Pejës, ku u takuan me udhëheqësit e ZMJ-së, Drejtoreshën Gentiana Kastrati dhe zyrtaren Adelina Shala. Takimi i radhës vazhdoi në Universitetin e Gjakovës, në takim me rektorin, Prof. Dr. Artan Nimani me prorektorë dhe nga ZMJ, Denis Spahija. Në të gjitha takimet u diskutua për përmbylljen e projektit HERAS, si dhe për bashkëpunimin e mirë dhe fillimin e projektit të Erasmus + "QUADIC".

- **Vizita 1 javore e studentëve të UKZ në Universitetin e Zug (15-21.12.2019)**

20 studentë të Universitetit ''Kadri Zeka'' në Gjilan, kanë qëndruar për një vizitë studimore në Zvicër, respektivisht në Universitetin ZUG. Studentët, së bashku me Rektorin Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka dhe Zyrtaren për Marrëdhënie me jashtë znj. Luljete Berisha, kanë qëndruar në ZUG deri më 21. 12.2019.

Një pritje madhështore u është bërë të gjithë studentëve të UKZ-së nga studentët e Zug, të cilit ishin paraprakisht në vizitë dy muaj më herët në Gjilan. Secili në mënyrën e vet, kishin përgatitur aktivitete të ndryshme në shenjë mirënjohje për mikpritjen e bërë në Gjilan gjatë qëndrimit të tyre një javor.

Ndërkaq ditëve në vijim, në vizitën e tyre studimore, studentët e Universitetit tonë të shoqëruar edhe nga studentët e Universitetit ZUG, gjatë qëndrimit të tyre një javor kanë marrë pjesë nëpër aktivitete të përbashkëta, Takimi i parë ishte me rektoren e PH Zug znj Esther Kamm si me me kryetarin e Zug. Kryetari mbajti një ligjëratë përpara studentëve tanë dhe pastaj u zhvillua një diskutim interaktiv dhe Kryetari mbeti i habitur me pyetjet dhe diskutimin e studentëve të UKZ drejtuar atij dhe rektores znj. Kamm.

Ndër aktivitetet tjera që janë zhvilluar janë edhe dy seminare, njëri për robotikë ndërsa tjetri për perspektivat e migracionit.

Vizita nëpër shkollat e Zugut e studentëve tanë. Një pjesë e tyre vizituan edhe Fakultetin Juridik të Universitetit të Zurihut. Një eksperiencë e jashtëzakonshme për të gjithë.

Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka ka mbajtur një ligjërate mbi migrimin si fenomen dhe ndikimin e tij në Kosovë para disa studentëve dhe profesorëve nga PH Zug, si dhe studentëve tanë, që po qëndrojnë në Zvicër. Po ashtu përvojat e saj i ndau edhe studentja nga Fakulteti i Edukimit në UKZ, Çlirimtare Gashi, e cila pati një fjalë rasti gjatë këtij ligjërate. Si ka ndikuar dhe po ndikon migrimi nga Kosova për në vendet e BE-së dhe çfarë ndikimi kanë remitencat nga diaspora u paraqitën gjithashtu gjatë kësaj ligjërate.

Ndryshe, edhe studentët e Universitetit ZUG, për dy vite radhazi kanë qëndruar në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan, kjo si rrjedhojë e marrëveshjes së bashkëpunimit që UKZ ka me Universitetin ZUG.

Duhet të theksohet se për të realizuar këtë vizitë, është bërë një punë e jashtëzakonshme nga Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar e UKZ-së. Studentëve u janë hequr të gjitha shpenzimet, përveç sigurimit në udhëtim që është dashtë të paguajnë secili nga 12 euro. Shpenzimet e vizës janë hequr fal angazhimit të zyrës në konsultim të vazhdueshëm me Ambasadën Zvicerane në Prishtinë. Të gjithë studentët kanë aplikuar në grup për vizë dhe janë pranuar pa termin nga ana e ambasadës. Shpenzimet e transportit janë mbuluar nga UKZ. Të gjithë kanë shkuar në mënyrë të organizuar me autobus deri në Zug, ku janë takuar me studentët zvicerane. Fjetjen dhe ushqimin ( mëngjes dhe darkë) e kanë dhënë secili studentë zvicerane që i ka pranuar studentët tanë në shteti, ndërsa dreka u është hequr nga PH Zug. Shpenzimet transportit nëpër Zug janë hequr nga vet universiteti i Zug. Gjithashtu falë angazhimit tonë si zyre dhe lidhjeve me bashkatdhetar, studentët tanë kanë qenë të ftuar në darka nëpër restorant të ndryshme që udhëhiqen nga shqiptarët. Pastaj bashkatdhetarët tanë në fund u kanë dhënë edhe dhurata studentëve tanë kur janë nisur për Kosovë.

Ky lloj i mobilitetit, i pari në Kosovë për nga lloji, është tejet i rëndësishëm për studentët tanë, pasi që për herë të parë po iu ofrohet mundësia e shkëmbimit dhe vizitës në një universitet prestigjioz siç është PH Zug në Zvicër. Tani më studentët tanë dhe ata të Zug kanë krijuar një miqësi të vërtetë mes vete, jo dëshmohet me vizitat tjera private që studentët e Zug u kanë bërë studentëve tanë.

- **Vizita e përfaqësuesve të Ambasadës Amerikane në Kosovë (20.11.2019)**

Në UKZ ka qëndruar një delegacion nga Ambasada Amerikane në Kosovë. UKZ ka prezantuar zhvillimet, synimet dhe sfidat e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan para delegacionit të Ambasadës së SHBA në Kosovë të udhëhequr nga z. Ray Nayler, zëvendësdrejtor i Sektorit për Marrëdhënie me Publikun i Ambasadës Amerikane.

Ne i treguam sukseset e UKZ në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar të UKZ-së, aktivitetet nga projektet në kuadër të programit ERASMUS+, akreditimin dhe rritjen e UKZ në 5 Fakultete, 10 programe studimore dhe dy nivele të studimeve - baçelor dhe master, si dhe sfidat me të cilat ballafaqohemi dhe strategjitë për tejkalimin e tyre me sukses.

Mysafirët e nderuar vlerësuan punën tonë duke na ofruar mbështetje të fuqishme në promovimin e vlerave akademike, shkencore dhe intelektuale të cilat u konsideruan thelbësore për një shoqëri dhe shtet të zhvilluar dhe bashkëkohor. U bisedua edhe mundësia e hapjes së American Corner në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan.

- **Vizita në Lubjanë të Sllovenisë për 100-vjetorin e Universiteti të Lubjanës (3.12.2019)**

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, bashkë me prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka, po marrin pjesë në ceremoninë e 100 vjetorit të themelimit të Universitetit të Lubjanës.

Gjithashtu rektori Kosumi ka marrë pjesë edhe në Konferencën e Rektorëve të Evropës Juglindore. Në këtë konferencë janë diskutuar shumë mundësi bashkëpunimi, e sidomos në projekte Erasmus + dhe Horizon 2020. Ndryshe, Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan në prill të këtij viti është bërë anëtar i Forumit të Rektorëve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor.

- **Vizita e studentëve dhe e një profesorit nga Helsinki, Finlandë (27.11.2019)**

Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan e kanë vizituar disa studentë të Universitetit Haaga Helia të Finlandës, Annika Rautavaara (Bachelor of Tourism and event management, Mia Miki (Bachelor on Tourism and event management) Ardiana Durmishi (Aviation business )Fleur Ossude (Management of

export area) Getoar Thaqi (ambassador of Haaga Helia and International Sales and Marketing), nënë udhëheqjen e profesorit të tyre, Prof. Dr. Evariste Habiyakare. Ata janë pritur nga Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi, Prorektor për Mësim, Kërkime Shkencore dhe Çështje të Studentëve dhe Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka, prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe bashkëpunëtorët tjerë. Kjo vizitë është realizuar në kuadër të një projekti nga një kompani finlandeze e interesuar për të investuar në Kosovë. Njëkohësisht gjatë këtij takimi është biseduar rreth mundësisë së bashkëpunimit në të ardhmen mes Universitetit Haaga Helia dhe Universitetit "Kadri Zeka". Pas përfundimit të takimit, mysafirët nga Finlanda kanë vizituar Universitetin "Kadri Zeka" ku kanë parë nga afër ambientet në të cilat zhvillohet procesi mësimor.

- **Vizita e disa profesorëve nga Schwamendigeni i Zvicrës (26.4.2019)**

Mësimdhënës nga shkolla e nivelit fillor Leutschenbach, më mësim tërëditor në Schwamendingen, Kanton i Cyrihut të Zvicrës, në të cilën mësojnë edhe nxënës shqiptarë, kanë qëndruar në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan, ku janë pritur nga dekani i Fakultetit të Edukimit Januz Dervodeli dhe stafi tjetër akademik.

Dekani Dërvodeli i ka njoftuar mysafirët rreth aktiviteteve mësimore, me ç'rast kanë vizituar sallat ku zhvillohet procesi mësimor në UKZ, dhe kanë parë nga afër mënyrën e ligjërimit, derisa mësimdhënësit nga Schwamendingeni janë shprehur të entuziazmuar me punën e mësimdhënies tek ne që sipas tyre nuk dallon nga ajo në Zvicër. Ndryshe mësimdhënësit nga shkolla e nivelit fillor Leutschenbach në Schwamendingen, Kanton i Cyrihut të Zvicrës, Shqipe Isufi, Halit Kadriu, Alina Ringli, Luana Carbone, Martin Neff, Ursula Stanice, Daniel dhe Barbara Fritschi, kanë zhvilluar vizita edhe nëpër shkollat e komunës së Gjilanit, me qëllim të njohjes me mësimin që zhvillohet në Kosovë, sepse siç thonë ata nuk pajtohen me rezultatin e fundit të PISA-s, dhe për këtë dëshirojnë t'iu prezantojnë perëndimorëve që edhe në Kosovë ka rregull dhe mësohet, respektivisht edukohet.

**Vizita monitoruese**

- **Zyra e Erasmus + në Kosovë, ka qenë në vizita të ndara monitoruese për dy projektet që kanë filluar në 2019: SMAHPC dhe e-VIVA**

Në UKZ është mbajtur vizita Monitoruese e Zyrës Erasmus+ në Prishtinë lidhur me Projektin "Student-run Multidisciplinary Allied Health Practice Center".

Në kuadër të projektit SMAHPC (Student-run Allied Multidisciplinary Health Practice Center), në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan kanë qëndruar zyrtarë të zyrës Erasmus + në Prishtinë të cilët fillimisht kanë pasur një takim me rektorin Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi dhe Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar Prof. Ass. Dr. Dukagjin Leka, si dhe më pas me stafin akademik dhe

administrativ me qëllim të reflektimit të proceseve të përfunduara deri më tani në projektin në fjalë si dhe hapat e ardhshëm të projektit.

Ndryshe Projekti "Student-run Multidisciplinary Allied Health Practice Center", është një projekt i financuar nga Komisioni Evropian në kuadër të programit Erasmus +, koordinator është Kolegji Heimerer, kurse partnerë janë, Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, Metropolia University Finlande, JAMK University Finlande, Manisa University Turki, Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë, MASHT, Instituti i Evropës Juglindore për Politika Shëndetësore dhe Sociale si dhe nga Organizata Joqeveritare Autizmi ne Kosovë. Ky projekt është planifikuar të realizohet gjatë punëtorive, vizitave studimore , konferencave, të cilat do të mbahen në shtetet prej nga vijnë partnerët e projektit dhe të gjitha këto do të realizohen prej tani deri në vitin 2021

**Raporti përfundimtar i auditorit të jashtëm**

itin 2019 nga ana e auditorit e kemi pranuar vetëm një vërejtje lidhur me pagesën e anëtarëve të Senatit ; cilën auditori pretendon se duhet bërë vetëm kur mbahen mbledhjet, kurse universiteti i ka kthyer igjen se senatori i cili nuk merr pjesë në mbledhje e cila organizohet vetëm një herë në muaj nuk ›ensohet përndryshe sipas rregullores dhe interpretimit tonë anëtarët e Senatit duhet paguar çdo muaj ɔdh edhe me universitetet e tjera publike.